



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 23.9.2022

Lënda: Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 23.9.2022, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 269/2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Valdete Hoxha

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303, të Kodit të Procedurës Civile, Komisioneri Publik, pasi vlerësoi parashtrimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përcjellë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën nr. ***/** prot., datë 6.9.2022, administruar në cilësinë e provës në seancën gjyqësore të datës 13.9.2022, në raport me secilin shkak ankimi, konstaton sa vijon:

I. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. Lidhur me shkakun ankimor për vlerësimin e aftësisë financiare të personit tjetër të lidhur, znj. ***.**, për t’i dhënë hua personit të lidhur, vajzës së subjektit të rivlerësimit, shumën totale 93.952,08 CAD (dollarë kanadezë) dhe dhurimet në shumën 11.500 CAD, në favor të familjes së subjektit, ky i fundit, në seancën e datës 13.9.2022, ndër të tjera, ka parashtruar se banesa në Kanada është blerë nga huadhënësit 6 vite përpara se të fillonte marrëdhënia e huas. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se Komisioni ka kryer drejt analizën financiare të familjes ***, nga e cila rezulton se kjo familje ka pasur mjaftueshmëri të ardhurash për dhënien e huas dhe për të kryer dhurimet. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka depozituar katër akte të reja, si vijon:

- Kopje të kontratës së shitblerjes të pasurisë së paluajtshme në Kanada, blerë nga familja ***, për vlerën 246.500 CAD, datë *.4.2006;

- Kopje të certifikatës së pronësisë, datë **.5.2006, dhe shënime të veçanta për bankën kredidhënëse, The Bank *** ***(***);
- Kopje e shkresës së ***, drejtuar çiftit ***, në datën **.5.2006, ku citohet se pagesa mujore e kredisë principal plus interes është në shumën 1.002,78 CAD;
- Nxjerrje llogarish bankare, në emër të z. ***.***, pranë *** Bank, për vitet 2010-2021.

1.1 Nga analizimi i akteve të sipërcituara, Komisioneri Publik konstaton se investimi i kryer në Kanada, nga familja **., është kryer disa vite përpara se të fillonte marrëdhënia e huas dhe e dhurimit me personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit. Rezulton se kredia e marrë nga familja ***, për qëllim të këtij investimi në Kanada, me këst mujor në shumën 1.002,78 CAD, nuk ndikon në aftësinë financiare të tyre për të mbuluar huat dhe dhurimet e dhëna familjes së subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, referuar të dhënave mbi llogaritë bankare të z. *** në *** Bank, rezulton se ato janë përdorur për transaksionin e shitblerjes së pasurisë në Tiranë, në shumën rreth 75.000 euro, dhe rezulton se për periudhën 2010-2016, në këto llogari nuk ka pasur kursime të tjera në vlera domethënëse.

1.2 Sa më sipër, Komisioneri Publik vëren se nga aktet e administruara për qëllim të këtij gjykimi gjyqësor, nuk u konstatuan rrethana të tilla faktike, që do të çonin në një vlerësim të ndryshëm nga ai i arritur nga Komisioni, lidhur me aftësinë e familjes ***. për të mbuluar me të ardhura nga burime të ligjshme huat dhe dhurimet e kryera në favor të familjes së subjektit të rivlerësimit.

2. Lidhur me shkakun ankimor për shlyerjen e huas në shumën 13.775,48 CAD (dollarë kanadezë) në vitin 2016, nga personi i lidhur, znj. ***.***, vajza e subjektit të rivlerësimit, kundrejt hallës së saj, znj. ***.*** dhe gjendjen e detyrimit të mbetur të pashlyer, subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 13.9.2022, ndër të tjera, parashtroi se vajza e saj ka deklaruar gabim gjendjen e detyrimit të mbetur në fund të vitit 2016 dhe 2017, dhe se ky gabim është konstatuar dhe është ndrequr në deklaratimet periodike vjetore për vitet 2018 dhe 2019, duke depozituar si provë këto deklarata. Konstatohet se pretendimi i subjektit të rivlerësimit qëndron, detyrimi i mbetur në fund të viteve respektive rezulton se është korrigjuar.

2.1 Sa i takon shlyerjes së detyrimit, deklaruar në DV-2016, subjekti i rivlerësimit ka prapësuar se në lëvizjet e llogarive bankare të vajzës së saj, deri në 31.12.2016, pasqyrohen pagesat/transfertat për shlyerjen e huas të kryer nga vajza në llogarinë e znj. ***.***, dhe djalit të kësaj të fundit, ***.*** Për të provuar këtë pretendim, subjekti ka depozituar në cilësinë e provës aktet e mëposhtme:

- Deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.8.2022, ku shtetasja ***.*** deklaron se znj. ***.*** i ka shlyer gjatë vitit 2016 shumën prej 13.775,48 CAD;
- Shkresën nga *** ***(Bank), lidhur me shumën e transfertave të kryera nga znj. ***.*** te halla dhe djali i saj, për periudhën **.1.2015 deri në **.12.2016;
- Debit memo nga *** ***(Bank), në lidhje me një transfertë në shumën 4.400 CAD, në datë **.11.2016, kryer nga vajza e subjektit, znj. ***.***, në favor të ***.***.

2.2 Nga analizimi i akteve si më sipër, rezulton se vajza e subjektit të rivlerësimit ka kryer disa pagesa në favor të djalit të hallës së saj, z. ***.*** që për periudhën maj 2016 deri në **.12.2016, që janë në total në vlerën rreth 5.300 CAD, si dhe një transfertë në favor të hallës së saj, znj. ***.***, në shumën 4.400 CAD.

2.3 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se një pjesë e shlyerjes së huas është kaluar në favor të djalit të huadhënëses, Komisioneri Publik vëren se shkresa e depozituar nga subjekti, lëshuar nga ***.*** Bank, i përket periudhës **.1.2015 – **.12.2016, ndërkohë që në DV-2016 dhe gjatë hetimit administrativ është deklaruar se shlyerja e huas ka filluar nga muaji maj i vitit 2016. Nga pasqyrat e llogarisë bankare të vajzës së subjektit, pranë *** Bank, konstatohet se transfertat e kryera në favor të z. ***.***, në total rreth 5.300 CAD, dhe në favor të znj. ***.***, në shumën 4.400 CAD, përveçse nuk korrespondojnë me shumën e deklaruar si të shlyer nga muaj maj 2016 deri në **.12.2016, por gjithashtu vërejmë se transfertat në favor të ***.*** janë kryer edhe para dhe pas kësaj periudhe, nga ku duket se këto transferime nuk lidhen me shlyerjet e huas ndaj znj. ***.***.

2.4 Sa më sipër, Komisioneri Publik konstaton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se shumata e kaluara në favor të z. ***.*** kanë qenë për shlyerjen e huas, së deklaruar në DV-2016, mbeten në nivel deklarativ dhe jo të provuara nga aktet e administruara. Për këtë shkak ankimor, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti arriti të dokumentojë vetëm një pagesë në shumën 4.400 CAD, të kryer nga vajza e saj, në favor të huadhënëses, znj. ***.***, fakt i cili do të reduktonte pamjaftueshmërinë e konstatuar për shlyerjen e detyrimit në vitin 2016 nga 13.775,48 CAD në 9.375,48 CAD ose rreth 890.000 lekë.

3. Lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar për pagesën e shumës 7.000 euro, për blerjen e automjetit tip *Ford Focus*, në vitin 2011, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka kërkuar që, në analizë për mjaftueshmërinë e blerjes së automjetit, të përfshihet gjendja *cash* e akumuluar ndër vite. Ndërsa për udhëtimin e kryer nga vajza e subjektit, gjatë periudhës **.7.2011-**.8.2011, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.8.2021, nënshkruar nga bashkëshortët ***, të cilët deklarojnë se të gjitha shpenzimet për këtë udhëtim (kostot e udhëtimit dhe të qëndrimit) janë mbuluar prej tyre.

3.1 Komisioneri Publik, për sa më sipër, vlerëson se pretendimi i subjektit për përfshirjen e kursimeve *cash* në analizën e burimit të ligjshëm, për blerjen e automjetit në vitin 2011, nuk bazohet në sa ka deklaruar subjekti në deklaratën periodike vjetore për vitin 2011, e për këtë arsye, nuk mund të pranohet. Ndërsa lidhur me shpenzimet e udhëtimit të vajzës së subjektit në vitin 2011, konstatohet se, edhe nëse marrim në konsideratë pretendimin se këto shpenzime janë mbuluar plotësisht nga familja ***, pamjaftueshmëria e konstatuar do të ishte në vlerën -387.091 lekë.

4. Duke përfunduar, Komisioneri Publik vlerëson se pasaktësitë e konstatuara në deklaratat periodike vjetore dhe atë “Vetting” (mosdeklarimi i dhurimeve¹), si dhe pamjaftueshmëritë e rezultuara në shlyerjen e huas në vitin 2016 dhe blerjen e automjetit në vitin 2011, në konsideratë

¹ Rezulton se dhurimet nuk janë deklaruar në Deklaratën “Vetting”, por ato janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore përkatëse.

të provueshmërisë së akteve të reja, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, për qëllim të këtij gjykimi, nuk janë të mjaftueshme për t'u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

II. Kërkimi përfundimtar i ankimit

5. Në vlerësim të përgjithshëm të procedurave të procesit të rivlerësimit, ashtu sikurse dhe praktika ka treguar, kërkimi i ankimit të Komisionerit Publik kundrejt juridiksionit kontrollues të Kolegjit, mund të jetë alternativ, kur rrethanat e faktit e lejojnë atë.

6. Në këto kushte, për rastin konkret objekt gjykimi, nga hetimi gjyqësor dhe në vlerësim të provave të administruara, bazuar në parimin e objektivitetit dhe të proporcionalitetit, vlerësojmë se nuk mund të kërkohet cenimi i vendimit. Për sa u arsyetua, përfundimisht, kërkojmë lënien në fuqi të vendimit nr. 269, datë 1.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO